

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Alarmi i rremë për bombë në një shkollë në Tiranë, Koçiu: Çmenduri e mirëfilltë kriminale. Hapësira publi ke nuk është fushë eksperimentesh
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sociale/alarmi-i-rreme-per-bombe-ne-nje-shkolle-ne-tirane-koc-iu-menduri-e-mirefi-i586080
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 15:52:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 16:30:19 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	490ad0e8c34da4a71d814b604caa62775c01f41fd3999e6364d11c924b28852c
TEKSTI	52970ea6efe359a7088523953e7455b7f7b9df2977a322d27f52c6eb142781aa
PAMJA	32478a58ce66d6aa4436af9daf9edd4169a653561043f3411771ba0a0f551c0f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	eda24991498d7698408eb876460ca0eb2f60baa27b415e2c78c0ac46a1113bc2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c5c495e1993bed01ae9e3c22701c0f0e7f56228ef65729414d07abaefa87f787
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/eda24991498d7698408eb876460ca0eb2f60baa27b415e2c78c0ac46a1113bc2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1 e [Ku banojnë 4.28 milione shtetasit shqiptare që kanë lindur në Shqipëri? "Mos të lejojmë provokimet" - Ministri gjerman i Mbrojtjes: Sulmi me dron në tren është përshkak fundit](#)

Alarmi i rremë për bombë në një shkollë në Tiranë, Koçiu: Çmenduri e mirëfilltë kriminale. Hapësira publike nuk është fushë eksperimentesh



14 Shtator 2026, 18:30Sociale TEMA



Zv.kryeministrja Albana Koçiu ka reaguar pas alarmit të rremë për një sulm terrorist në një shkollë 9-vjeçare në Tiranë, ngjarje që ndodhi mëngjesin e 14 shtatorit, në ditën e parë të nisjes së mësimin.

Koçiu e ka dënuar ashpër ngjarjen, për të cilën është arrestuar edhe autori përgjegjës, duke theksuar se një alarm i tillë, në një moment kur shkollat janë të mbushura me fëmijë, nuk mund të konsiderohet një shaka apo një veprim i pamatur.

"Një alarm i rremë për bombë në një shkollë në Tiranë, ditën e parë të mësimin, kur oborret janë të mbushura plot me fëmijë, nuk është një shaka e hidhur, nuk është një test cinik për refleksin e Policisë së Shtetit dhe as një lajthitje e rastësishme e një mendjeje të papjekur, por një çmenduri e mirëfilltë kriminale", shkruan Koçiu.

Zv.kryeministrja e ka lidhur ngjarjen edhe me debatin mbi lirinë e shprehjes, duke kritikuar ato që i cilëson si sjellje që kalojnë kufijtë e ligjshmërisë dhe krijojnë panik te qytetarët.

"Kjo lloj çmendurie që shpesh tolerohet nën alibinë e një 'lirie' pa fre, nuk ka asgjë të përbashkët me lirinë e vërtetë", shprehet ajo.

Koçiu kërkon që ndaj personave që ndërmarrin veprime të tilla të ketë një reagim të shpejtë të ligjit, duke argumentuar se hapësira publike nuk mund të përdoret për të krijuar panik apo për të vënë në provë sigurinë e qytetarëve.

"Këtyre që ndosin protestën, që e ngatërrojnë lirinë me anarkinë e mendjeve të tyre të boshatisura, duke e kthyer hapësirën tonë publike në një fushë eksperimentesh të dështuara, ligji duhet t'u tregojë shumë shpejt se Shqipëria nuk është një teatër ku mund të luajnë falas dramën e tyre të sëmurë. Refuzimi i këtyre sjelljeve anormale duhet të jetë qëndrim i të gjithë shoqërisë", shkruan Koçiu.

Gjatë ditës së sotme u arrestua një 47-vjeçar, me initiale M. J., i dyshuar për dhënien e alarmit të rremë. Sipas autoriteteve, rreth orës 06:30, ai ka telefonuar

Policinë e Tiranës duke pretenduar se në një shkollë 9-vjeçare kishte terrorizëm dhe lëndë të shkatërrimit në masë.

Pas sinjalizimit, në shkollë shkuan shërbimet e Policisë, Njësia Antieksplziv dhe Njësia Antiterror, të cilat kryen kontrollet e nevojshme. Nga verifikimet rezultoi se informacioni ishte i rremë dhe se nuk kishte lëndë të rrezikshme.

Hetimi zbuloi gjithashtu se 47-vjeçari dyshohet se e kishte publikuar informacionin e rremë edhe në rrjetet sociale.

M. J. akuzohet për veprat penale “Njoftimi i rremë në organet e rendit” dhe “Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik”. Materialet procedurale i janë referuar Prokurorisë së Tiranës për veprime të mëtejshme.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Ish-deputeti Alban Xhelili emërohet drejtor i Postës Shqiptare në Durrës!

17:10 Sociale / 1 koment

Pushteti Vendor halllka e dobët, 20 incidente kibernetike në 6 muaj, 4 kritike me prekje të dhënash

16:20 Sociale

Rrugëtimi drejt dijes nis me mbështetje, One Albania pranë 100 fëmijëve pa kujdes prindëror të Fshatit SOS

14:20 Sociale

Fluturimet gjatë verës: Shqipëria mes vendeve me rritje të lartë të trafikut ajror

14:10 Sociale

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.